



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____

PËR

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 784, DATË
18.12.2024 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E
RREGULLAVE PËR ZHVILLIMIN E ZONAVE AEROPORTUALE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 28, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 784, datë 18.12.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për zhvillimin e zonave aeroportuale", bëhen këto ndryshime:

1. Pika 6, ndryshohet si më poshtë:

"6. Lejet për zhvillim apo ndërtim në zonat e mbrojtura të aeroportit merren pranë autoritetit përgjegjës për zhvillimin e territorit, sipas rregullave të përcaktuara në Aneksin 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, si dhe në përputhje me parashikimet e vendimit nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar."

2. Pika 7, ndryshohet si më poshtë:

"7. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe autoritetet vendore të zhvillimit të territorit marrin

mendimin e Autoritetit të Aviacionit Civil për çdo praktikë aplikimi për leje zhvillimi, leje ndërtimi apo praktikë hartimi dokumentesh për planifikim të territorit, që përmban objekte, struktura apo instalime që ndodhen në zonat e mbrojtura të aeroportit.”

3. Pika 8 ndryshon si më poshtë:

“8. Çdo objekt apo strukturë e planifikuar për ndërtim apo instalim në zonat e mbrojtura të aeroportit duhet që të marrë, miratimin nga AAC-ja. Miratimi i AAC-së, jepet vetëm për zhvillimin apo ndërtimin e objekteve që sjellin pengesa për operimet ajrore.”.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, autoritetet vendore të zhvillimit të territorit dhe Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA